



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Pritjenoh/Prodato Received/Delivery	12.12.2023	3	viti god veçri
Organ /Njesia Org./Unit	Nr Prot B/ Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMBIA	7426/2023		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1382/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përputhje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë dhe Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1382/2023 të datës 06.11.2023 të parashtruar nga ankuesja _____, të cilën e përfaqësona me autorizim avokatura _____ me adresë: Bulevardi i Dëshmoreve te Kombit Nr., 58. Ulpianë, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme/DMZP, në çështjen juridike 'kontestim konkursi', duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datën 12.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Detyrohet Komisioni për Pranim për Institucionet e Administratës Shtetërorë për grupin „Specialist i Përgjithshëm i Shëndetësisë/Mjekësisë” ‘pranë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij Vendimi të nxjerrë akt administrativ lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesja _____

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ministria e Punëve të Brendshme më datë 11.07.2023 ka njoftuar për shpalljen e konkursit me Nr. Referencë: RN00012041 për grupin Specialist të Përgjithshëm të Shëndetësisë/ Mjekësisë respektivisht për pozitën “Inspektor Shëndetësor”, ku afati për aplikim ka qenë nga data 01.08.2023 deri më datë 09.08.2023. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja, ku më datë 21.08.2023 është bërë përzgjedhja e kandidateve në listën e ngushtë ku ankuesja ka arrit të jetë pjese e listës së ngushtë e cila respektivisht është renditur e 3-ta sipas numrit rendor. Ankuesja në testin me shkrim ka arrit të merr 46 pike ndërsa në vlerësimin e jetëshkrimit komisioni i vlerësimit ankuesen e kanë vlerësuar me 12 pikë, gjegjësisht sipas Renditjes përfundimtarë të

datës 19.10.2023 ankuesja ka arrit të merr gjithsejtë 58 pikë duke mos pasur mundësi të kalojë në fazën e intervistës me gojë.

Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit ne Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik me date 23.10.2023 ka shpallur njoftimin lidhur me kandidatin fitues.

Ankuesja e pa kënaqur me vlerësimin e Komisionit të Pranimit për pjesën e jetëshkrimit, me datë 24.10.2023 ka parashtruar ankese pranë Komisionit të Pranimit, me pretendim se në vlerësimin e CV ankueses i është bërë padrejtësi. Ndërsa Komisioni i Pranimit përmes përgjigjes (pa datë dhe numër) i ka dhënë vetëm një sqarim se si është vlerësuar ankuesja.

Kundër njoftimit të Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik të datës 19.10.2023 për kandidatin e përzgjedhur ankuesja me datë 06.11.2023 ka parashtruar ankesën me numër të proktollit 6875/2023 e cila është regjistruar me numër A.nr.1382/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me pretendim ankimor se vlerësimi i CV nga ana e Komisionit është jo profesional duke konsideruar se i është bërë e pa drejtë, po ashtu ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës e kundërshton Përgjigjen e marr nga Komisioni i Pranimit pasi qe i njëjti ka shkelje të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 08.11.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Punëve të Brendshme. Ndërsa Këshilli me datë 15.11.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:

Ankesën me numër protokollit 6875/2023 të datës 06.11.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin pa date dhe numër; Dokumentin e identifikimit; Përgjigjen e Komisionit të Pranimit drejtuar ankueses; Njoftimin pa date të SIMBNJ-së; Renditjen sipas SIMBNJ-së lidhur me rezultatin e vlerësimit të ankueses; Njoftimin e SIMBNJ-së lidhur me listën e ngushtë; Njoftimin lidhur me pjesëmarrjen e testit me shkrim; Njoftimin lidhur me rezultatet e vlerësimit të CV-së; Kërkesën për përgjigje në ankese të datës 08.11.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 15.11.2023; Konkursin me numër të Referencës RN00012041 të datës 11.07.2023 për Grupin Specialist të Mjekëses; Vendimin me numër 02/161 të datës 25.09.2023 për emërimin e komisionit të pranimit; Njoftimin lidhur me listën e ngushtë të kandidateve; Njoftimin lidhur me plotësimin ngushtimin e listës së ngushte; Aplikacionin e ankueses së bashku me shkresat përcjellëse; Diplomën me numër 4329 të datës 31.05.2016; Certifikatën e datës 30.03.2017; Pasqyrën e llogarisë Trustin e datës 01.08.2022 deri me date 27.07.2023; Vërtetimin e datës 27.07.2023; Certifikatën mbi dënimin e penale të datës 25.07.2023; Licencën e punës; Deklaratën e datës 03.08.2023; Rezultatet e vlerësimit për të gjithë kandidatet veç e veç; Ankesën e datës 24.10.2023 të parashtruar nga ankuesja tek Komisioni i Pranimit; Përgjigjen e Komisionit të Pranimit; Renditjen përfundimtare të kandidateve të datës 19.10.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, duke u bazuar në nenin 16 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të



Kosovës, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e parashtruara të lëndës dhe ka konstatuar se janë përmbushur kushtet ligjore për detyrimin e Komisionit për Pranim për Institucionet e

Administratës Shtetërorë për grupin „Specialist i Përgjithshëm Shëndetësor/Mjekësisë ” pranë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik, që ti ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore për të vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesja *sepse:*

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, pretendon se vlerësimi i CV nga ana e Komisionit është jo profesional duke konsideruar se i është bërë e pa drejte, po ashtu ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës e kundërshton Përgjigjen e marr nga Komisioni i Pranimi pasi që i njëjti ka shkelje të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative.

Kolegji i Këshillit, konstaton së në konkursin Nr. Referencë: RN00012041 për grupin Specialistë të Përgjithshëm të Shëndetësisë/Mjekësisë respektivisht për pozitën *Inspektor i Shëndetësisë*, kriteret e përgjithshme formale kanë qenë:

- *Arsinimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë me së paku 3 vite të studimeve në fushat; Mjekësi e Përgjithshme, Mjekësi tjetër dhe Menaxhim Mjekësore;*
- *Përvoja e punës: Se paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitë së lirë të punës.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në provat e lëndës ka konstatuar se Komisioni për Pranim për Institucionet e Administratës Shtetërorë për grupin „Specialist i Përgjithshëm i Shëndetësisë/Mjekësisë”, pranë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik në rastin konkret, nuk e ka adresuar dhe nuk e ka shqyrtuar ankesën e ankueses lidhur me vlerësimin e jetëshkrimit, pasi që të njëjtit lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesja Albina Hoxha i kane kthyer një përgjigje e cila nuk përmban as datë dhe as numër protokollit, respektivisht Komisioni nuk ka nxjerr vendim apo akt administrativ ashtu siç përcaktohet me nenin 25 paragrafi 5 dhe 6 të Rregullores (QRK), NR. 16/2020 Për Pranim dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës i cili përcakton se 5. *Kundër rezultatit të fazës së vlerësimit, kandidati i pakënaqur, mund të parashtojë ankesë të brendshme, brenda tri (3) ditëve nga data e njoftimit individual. 6. Ankesa shqyrtohet nga Komisioni i Pranimi dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj”,* andaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar që përgjigja e cila nuk përmban as datë dhe as numër protokollit i Komisionit për Pranim për Institucionet e Administratës Shtetërorë për grupin „Specialist i Përgjithshëm i Shëndetësisë/Mjekësisë”, përveç që është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L - 114 Për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK), NR. 16/2020 Për Pranim dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës është në kundërshtim edhe me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative, gjegjësisht me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 dhe me nenin 48 paragrafi 2 që rregullojnë formën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ, sepse përgjigja e kthyer ndaj ankeses së parashtruar nga ankuesja nuk përmbanë elementet e një akti administrativ, ashtu siç është përcaktuar me nenin 47 të këtij ligji ku theksohet qartë se : 1. *Akti administrativ i shkruar përmban: 1.1. pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes; 1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i*



zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit. 1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin); 1.4. pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjete juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë”, rrjedhimisht Komisioni për Pranim për Institucionet e Administratës Shtetërore për grupin „Specialist i Përgjithshëm i Shëndetësisë/Mjekësisë”, pranë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik ankueses në ankesën e parashtruar i ka kthyer vetëm një përgjigje pa nxjerr akt administrativ ne kundërshtim me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren (QRK), NR. 16/2020 Për Pranim dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Andaj, duke marr parasysh rrethanat si me lartë, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni për Pranim për Institucionet e Administratës Shtetërore për grupin „Specialist i Përgjithshëm i Shëndetësisë/Mjekësisë”, pranë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik, është i obliguar që të ndërmarr veprime ligjore për shqyrtimin e ankesës së parashtruar nga ankuesja në mënyrë që të vërtetojë drejtë gjendjen faktike dhe rrjedhimisht të nxjerr akt administrativ në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligji Nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe Rregulloren(QRK), NR. 16/2020 Për Pranim dhe Karrierën ne Shërbimin Civil Të Republikës së Kosovës, sepse përgjigja (pa date dhe numër) e kthyer nga Komisioni i Pranimit nuk përmban elementet e aktit administrativ.

Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.1382/2023

Ilire MEHMETI SHAQIRI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesve me autorizim
- Komisionit të Vlerësimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtareve Publik
- Udhëheqëses së Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.